

URDHËR
Nr. 53, datë 1.8.2024

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të neneve 28 e 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; të pikës 5, të nenit 21, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, Kuvendi i Shqipërisë, nëpunësit autorizues, Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, z. Genci Gjonçaj.
2. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, për Kuvendin e Shqipërisë:
 - a) Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, z. Genci Gjonçaj, për procedurat e prokurimit publik;
 - b) Në mungesë të z. Genci Gjonçaj apo në pamundësi të ushtrimit të kompetencave, sipas pikës 2.a të këtij urdhri, znj. Merita Qato, drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Legjislativ, delegohet për nxjerrjen e akteve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit të parashikuara në këtë pikë.
3. Kompetencat e deleguara të titullarit të Kuvendit të Shqipërisë, do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në përfundim të legjislaturës së X parlamentare.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Elisa Spiropali